



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 582/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e organizatës së Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Mustafë Selimi në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit (VV) 0404D/02R, fshati Bresalc komuna e Gjilanit, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET ankesa si e pabazuar e organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga organizata BIRN, ne te cilën pretendohet se “më datë 12.12.2010, kryesuesi (VV) 0404D/02R, Mustafë Selimi në fshatin Bresalc komuna e Gjilanit, pas përfundimit të numrit të votave nuk e ka nxjerr kutinë e votimit në pikën grumbulluese, por e ka lënë në klasë, ku nuk ka qenë asnjë njëri”.

Parashtruesi i ankesës nuk ika bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, janë pabazuara për shkak se nuk është ofruar dëshmi për të besuar se me date 12.12.2010 ka pasur parregullsi te procesit zgjedhor nga ana e Mustafe Selimit kryesues te VV 0404D/02R, fshati Bresalc, komuna e Gjilanit. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 582/2010 më datën 15.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

